Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Kroacisë:

Dr. Ljuba Rauski Naglic: +385-915176510

Dr. Eugenija Sojat Marencic: +385-915107070



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SLLOVENISË

- 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 5., tel: +386-1-562-3640. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.
- Adresa e magazinës së Lendavait: Kolodvorska 14., 9220 Lendava. tel: +386-2-575-1270. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Numri i Telecenterit (ku bëhen porositë telefonike) është: 01/563-7501

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Sllovenisë:

Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788

Dr. Canzek Olga: +386-41824163



Zyra e Lendvait



NJOFTIMET E ZYRËS SË KOSOVËS

- Prishtinë, Rr. Zagrebi PN, tel.: +381-38-240-781.

www.flpseeu.com FLP TV në internet

Programi i FLP TV Nga 27 korrik deri më 15 shtator 2007

10.00 Zsolt Laszlo Geczó dhe Geczóne Laszlo Zsolt - Pavarësia e sistemit marketing	16.35 Dr. Anna Schmitz – Ujë mineral Forever	23.30 Dr. Terezia Samu – Përralla e aloe-s së mrekullueshme
10.20 Film prezantues produktesh – Pro6	16.55 Plani marketing i FLP-s	23.55 Karoly Lerant – E pamundura nuk ekziston
10.25 Film prezantues produktesh – Nature's 18	17.15 Katrin Bajri – Në majë me sistemin	00.20 Michael Strachowitz – Ndërtim rrjeti me sukses në FLP
10.28 Film prezantues produktesh – Aloe2Go	18.10 Ilona Bence dhe Gabor Maros – Këngë nga Cabarett Bonbonier	01.20 Koncerti i Lui-s
10.30 Kualifikime – Super Rally	18.30 Gabriella Dominko – Këmbëngulje, vull, bashkim dhe besim	01.40 Sonya Show 2005, Debrecen
11.12 Koncerti i Shadows Hungary Band	18.55 Piroksa Lukatsi Hegedúzne – Nga ëndrra realitet	02.25 Intervistë me Mariann Szeker-in
11.30 Dr. Terezia Samu – Përralla e aloe-s së mrekullueshme	19.30 Intervistë me Peter Perina-n	02.50 Grupi muzikor Rajko
11.55 Karoly Lerant – E pamundura nuk ekziston	20.20 Holiday Rally – Porec	03.05 Leksioni i zëvendës-presidentit të Europës, Aidan O'Hare
12.20 Michael Strachowitz – Ndërtim rrjeti me sukses në FLP	21.20 Koncert prezantues disku i Borago-s	03.25 Himni i FLP
13.20 Koncerti i Lui-s	21.40 Zsolt Fekete – Kap ritmin	03.30 Leksioni i zëvendës-presidentit të FLP-s, Gregg Maughan
13.40 Sonya Show 2005, Debrecen	22.00 Zsolt Laszlo Geczó dhe Geczóne Laszlo Zsolt - Pavarësia e sistemit marketing	03.45 Koncerti i Pataki Attila-s dhe Edda-s
14.25 Intervistë me Mariann Szeker-in	22.20 Film prezantues produktesh – Pro6	04.05 Fjala e presidentit-drejtorit të përgjithshëm të FLP-s, Rex Maughan
14.50 Grupi muzikor Rajko	22.25 Film prezantues produktesh – Nature's 18	04.35 Dr. Anna Schmitz – Ujë mineral Forever
15.05 Leksioni i zëvendës-presidentit të Europës, Aidan O'Hare	22.28 Film prezantues produktesh – Aloe2Go	04.55 Plani marketing i FLP-s
15.25 Himni i FLP	22.30 Kualifikime – Super Rally	05.15 Katrin Bajri – Në majë me sistemin
15.30 Leksioni i zëvendës-presidentit të FLP-s, Gregg Maughan	23.12 Koncerti i Shadows Hungary Band	06.10 Ilona Bence dhe Gabor Maros – Këngë nga Cabarett Bonbonier
15.45 Koncerti i Pataki Attila-s dhe Edda-s		06.30 Gabriella Dominko – Këmbëngulje, vull, bashkim dhe besim
16.05 Fjala e presidentit-drejtorit të përgjithshëm të FLP-s, Rex		06.55 Piroksa Lukatsi Hegedúzne – Nga ëndrra realitet

Business Builders Club

2007



1. Utasi István
2. Varga Géza dhe Vargané Dr. Juronics Ilona
3. Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin dhe Dr. Seres Endre
4. Senk Hajnalka
5. Tanács Ferenc dhe Tanács Ferencné 500, 91 %, 43 új A/S
6. Csuka György dhe Dr. Bagoly Ibolya
7. Nakic Marija
8. Dr. Debrődi Mária dhe Vágot Sándor
9. Kuzmanovic Vesna dhe Kuzmanovic Sinisa
10. Dr. Lukács Zoltán dhe Dr. Lukácsné Kiss Erzsébet



Shpërblimi i tyre:
Forever Holiday Rally,
Poreč



FOREVER LIVING PRODUCTS HUNGARI SHPK.

Rregullorja e zgjidhjes së konflikteve

Nëse ndërmjet Forever Living Products Hungari Shpk.-s ose çdo biznesi të lidhur me të ("FLP") dhe distributori të saj krijohet ndonjë konflikt në lidhje me produktet e tregëtuara nga FLP-ja, të dy palët me mirëkuptim, duke rënë dakort me njëri-tjetrin përpiqen ta zgjidhin konfliktin në mënyrë miqësore dhe reciproke.

Në rastin kur nuk bien dakort, çdo palë me deklaratën në shkrim të drejtuar palës tjetër mund të hap procesin e kompromisit sipas ligjit LV të vitit 2002 ("Procesi i Kompromisit").

Nisma për hapjen e Procesit të Kompromisit i duhet dërguar personalisht ose në letër me rekomandim palës tjetër, e cila vjen në fuqi kur arrin tek ajo. Dokumenti që vërteton marrjen është kopja e nismës së ardhur personalisht ose me rekomandim, e cila nënshkruhet nga përfaqësuesi zyrtar ose i autorizuar i palës. Në deklaratën e hapjes së procesit të kompromisit duhet shënuar data, dhe përveç dhënies së mundësisë së modifikimit duhen shënuar kërkesat dhe pyetjet që janë subjekti i procesit të kompromisit.

Nëse konflikti nuk zgjidhet gjatë procesit të kompromisit, ose palët nuk nisën një proces të tillë, me qëllim që të gjendet zgjidhja më e mirë, më e favorshme për të dy palët, më e shpejtë dhe më efektive, çdo palë mund të hap proces gjyqësor të zgjedhur përpara gjyqit të

zgjedhur të Urdhrit të Tregëtisë dhe Industrisë Hungareze, e cila vepron sipas rregullores së saj. Numri i gjykatësve është 3 (tre). Gjuha e procesit është gjuha hungareze.

Pala fituese merr përsipër shpenzimet e palës tjetër sipas vendimit të gjyqit të zgjedhur. Në shpenzime hyjnë tarifa e punës së avokatit, si dhe shpenzimet e bëra në lidhje me procesin gjyqësor.

Vendimi i gjyqit të zgjedhur është absolut, pra asnjë palë nuk ka të drejtë të hap proces në gjyq të rregullt apo në gjyq tjetër të zgjedhur, këtu duke mos marrë parasysh veprimet në lidhje me zbatimin e vendimit të marrë nga gjyqi. Ky kufizim nuk do të thotë që asnjë palë nuk mund të kërkojë nga një gjyq i rregullt masa të përkohëshme ose sigurie përpara gjyqit të zgjedhur ose gjatë tij, nëse kodi civil ia krijon mundësinë për këtë. Gjithashtu nuk e përjashton as procesin e nisur për anulimin e vendimit të gjyqit të zgjedhur.

Çdo konflikt ndërmjet palëve – këtu duke marrë parasysh edhe konfliktet e lindura pas përfundimit të kontratës aktuale – në mungesë të rënies dakort mes dy palëve mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet procesit gjyqësor të zgjedhur, nëse ligji hungarez nuk e përjashton zgjidhjen e konfliktit të caktuar nëpërmjet gjyqit të zgjedhur...



**TEREZIA
HERMAN**
soaring manager

Katër kërkesat bazë të njeriut

I dashur Lexues i Revistës FLP! E ke dëgjuar shpeshherë nga sponsori yt se sa e rëndësishme është teknika në biznesin FLP. Si të përcaktosh qëllime, të gësh përse-të – të shkruash listën e emrave – të ftosh njerëzit në takim – të mbash prezantime rreth produkteve dhe marketingut – të japësh paketa informacionesh – etj... Ky është njëri aspekt, por unë po ta shpjegoj nga një aspekt krejt tjetër këtë biznes.

Nëse ke akoma një punë me pagesë të mirë, ku sipas mendimit tënd kryen një punë të mirë e të ndershme, është e natyrshme që pret edhe vlerësim.

Por ndoshta shefi yt është vazhdimisht i pakënaqur me punën tënde, ose as nuk e vë re ekzistencën tënde në firmë, ose mendon në mënyrë të tillë: “derisa nuk them gjë, atëherë veproni si deritani”. Ndoshta nuk i ke mirë marrëdhëniet me kolegët?

Nuk çuditem nëse të duket sikur të mungon diçka, pasi asgjë nuk të dhemb më tepër se sa kur nuk të vlerësojnë, nuk të marrin parasysh.

Në vitin 1993 një firmë që transportonte pako bëri një studim të brendshëm. Pyetjet kishin të bënin me faktin se sa të kënaqur ishin të punësuarit me eprorët e tyre.

75% e të pyeturve u përgjigj: “është një ndjenjë e mirë kur shefi të thotë se ke bërë një punë të mirë”. 85% tha: “është krenar që shefi sillet me respekt me të.” Sllogeni i kësaj firme është: Njerëz + Shërbim = Fitim

Unë mendoj se ndërtojmë një biznes FLP të mirë nëse marrim parasysh **KATËR KËRKESAT BAZË TË NJERIUT.**

Këto vlera nuk mund t'i dëmtosh, sepse ato përcaktojnë gjithë jetën, marrëdhënien me partnerin, miqësitë dhe marrëdhëniet me njerëzit që të rrethojnë.

Aty ku këto kërkesa nuk plotësohen, ajo marrëdhënie herët a vonë merr fund dhe t'i largohesh prej saj.

Të shohim se përse mendova?

1. Të duan
2. Je me vlerë
3. Je i pavarur
4. Je i sigurt

1. Ndjenja e dashurisë: një nga kërkesat më të rëndësishme. E njeh gjuhën e dashurisë së partnerit tënd? Nëse nuk e di akoma, atëherë si pretendon ta duash! Disa fjalë të dashura apo momente romantike së bashku? Dhurata të dashura? Përqafim? Vëmendje? Asnjëri nuk pret nga ty të krijosh perla artistike, vetëm jep një pjesë nga zemra jote! Shiko fëmijën e vogël që jeton pranë teje! I kushton pak vëmendje dhe të përgjigjet menjëherë me një buzëqeshje. Është gati ta tregoj dashurinë ndaj teje pa asnjë kusht.

E ndjen se si FLP-ja e tregon dashurinë e saj ndaj teje? Psh. në çdo faqe të parë të revistës Forever mund të lexosh përshëndetjen plot dashuri të Rex Maughan-it. E thotë me besim: "Forca e Forever-it është forca e dashurisë". Në faqen tjetër mund të lexosh fjalët e drejtorit gjeneral Dr. Sandor Milesz. Ti si e tregon dashurinë tënde ndaj bashkëpunonjësve të tu? Ashtu si komunikimi, edhe dashuria ka kuptim nëse është e dyanëshme. Ti e jep, Ai e merr dhe e pranon. – Kalo me të kohë me vlerë!

Shtroj pyetjen: Unë apo Ti çfarë mund të bëjmë në qëllim të zhvillimit stabil të skuadrës?

- Lexova një thënie "**Ai që flet, çlirohet, kurse ai që hesht, të do**" -
- Kushtoji vëmendje!
 - Dëgjoje deri në fund! (edhe nëse

e di se çfarë do të pyes) Gjithmonë është mirë nëse nuk i pret fjalën.

- Buzëqesh! – Fjalë e urtë kineze: "Ai që nuk mund të buzëqesh, të mos hap biznes". Buzëqeshja i ngre shumë vlerat e fytyrës sonë.
- ... DHE THUAJI ATIJ! "**dashuria është vetëm një fjalë nëse nuk e përcjell dot.**" (tekst kënge)

2. Të jesh me vlerë – dëshira më e fortë nga gjithçka. Dy mënyrat më me vlerë dhe njëkohësisht të përdorura më pak të motivimit janë respekti dhe vlerësimi i sinqertë. Rruga e duhur është gjysëm metri që ndodhet ndërmjet kokës dhe zembrës tënde! Përcilli bindjet e tua dhe me këtë i nxit miqtë e tu për gjëra që as nuk i ëndërrojnë.

Si e shpreh FLP-ja vlerësimin e saj ndaj teje?

- Merr dhuratë revistën mujore të Forever-it,
- Si pjesë e programit motivues pagan kredinë e makinës tënde,
- Finansirozon pushimet e tua verore, mund të udhëtosh bashkë me më të mirët e FLP-s (në Europë, USA, bregdetin Kroat, etj...)
- Në datën 15 të çdo muaji të pagan bonuset e merituar,
- Ta vlerëson punën me medalje ari,
- Në aktivitetet Forever Success Day e vlerëson dhe duartrokit rezultatin tënd në praninë e mijëra njerëzve. Merr lule nga sponsorët e tu. Ai që e meriton merr shpërblim. "Më mirë të harrojmë lulet sesa njëri-tjetrin!"

Përsëri një pyetje: Unë apo Ti çfarë mund të bëjmë në qëllim të asaj që bashkëpunonjësi ynë ta ndjej veten me vlerë?

- Thjesht thuaja Atij! Jepi informacionet e duhura, ndërtoji dhe theksoji tiparet e mira! E dëgjojnë edhe të tjerët kur lavdëron dikë!
- Edhe fëmija reagon më me dëshirë ndaj lavdërimit se sa ndaj dënimit.
- Vlerësimi i mëson skuadrës tënde

që këtu rendimenti i mirë vlerësohet dhe shpërblehet.

– Ndiqe deri në fund jetën!

Linja ime e sipërme është një shembull i mirë për të gjithë ne: – **Rolf Kipp**, distributori më rezultativ i Europës, – **Jozsi dhe Marika Szabo**, drejtuesit më të mirë të Hungarisë, – **Miki Berkics**, mentori i vërtetë për mua, – **Aranka Vagasi dhe Andras Kovacs**, kampionët e mbështetjes, – **Gyuri dhe Zsofi Czele**, gjyshërit e mi në FLP, – **Zoli dhe Moni Becz**, gjithmonë e dinin se kur duhet të ishin pranë meje – por falenderoj shumë edhe sponsorin tim të drejtpërdrejtë, Laci Juhasz-in, që merrja pjesë në listën e tij, Tomi-n, me të cilin e filluam së bashku përpara 9 vitesh dhe e ndërtojmë së bashku prej 2 vitesh këtë biznes.

3. Të jesh i pavarur

Nëse diçka është e detyruar, e pranon me vështirësi ose e di menjëherë që nuk e dëshiron. Shiko fëmijën e vogël! Po t'i ndalosh diçka, e do akoma më shumë atë, dhe e bën me çdo kusht pavarësisht se e vë re apo jo.

Nëse nuk e ndjen se je i pavarur, atëherë në atë moment do të kesh ndjenja të këqija.

FLP-ja për mua përbën një nga llojet e pavarësisë. Nuk të pengon, punon kur ke dëshirë. Më thuaj diçka që është e detyruar në këtë punë! – nuk do të gjesh të tillë! Ky është një biznes i lirë,

- Biznesi yt,
- Shëndeti yt,
- Jeta jote,
- Jeta dhe shëndeti i familjes tënde.

Të gjithë e gjejnë ritmin e tyre në këtë biznes. Këtë biznes e bën me atë ritëm që imagjinon.

– Përsëri një pyetje: Unë apo Ti çfarë mund të bëjmë në qëllim të asaj që bashkëpunonjësi ynë ta ndjej veten të

pavarur? – Shumë e thjeshtë: Duaje Atë pa kusht! Të gjithë kanë “karta të hapura” në këtë biznes!

Më mbush me kënaqësi fakti që drejtuesit e mi e siguruan nëpërmjet këtij biznesi këtë lloj pavarësie për veten dhe familjen e tyre.

Zsolt dhe Anita Leveleki: prindërit e tre fëmijëve, njerëz me kuptimin e plotë të fjalës, drejtues shembullor.

Istvan dhe Rita Halmi: prindërit e dy fëmijëve, lojtarë të shkëlqyer skuadre, drejtues të njohur. **Julia Torcom:** nëna e pesë fëmijëve, ndihmëdhënëse, e vullnetshme.

Rex Alex: zotëron të kaluar si këngëtar, shpirt artisti. Kështu kryen punën dhe jeton jetën, lirshëm.

Janos dhe Etus Tamas: prindërit e tre djemëve. Rrjetndërtues të vullnetshëm, këmbëngulës, të qëllimshëm dhe aktiv.

4. Të jetosh në siguri

Njerëzit kur vjen koha e ndryshimit, nuk janë në gjendje të shkëputen nga rrjedha e përditshme. Zhvillimi është një mundësi, një vendim me të cilin mund të krijosh sigurinë në jetën tënde. Nga se është një njeri i sigurt?

– Kur e ndjen se mund të mbështetet tek Ty dhe tek skuadra.

FLP-ja të jep sigurinë:

- Gjithmonë do të ketë Aloe Vera.
- E zgjeron vazhdimisht ofertën me produkte me cilësi të mirë.
- Në gjithë shtetet e botës FLP, edhe në Hungari prej 10 vitesh në datën 15 të çdo muaji të dërgon llogarinë dhe të paguan bonuset.
- Ta ndihmon punën me lëndë ndihmëse dhe mësimdhënëse.
- Mund të mësosh nga managerë dhe rrjetndërtues të huaj.
- Linja e sipërme merret me ty.

Pyetja ime: Unë apo Ti çfarë sigurie mund t'i japim? Në radhë të parë të interesohesh se si e ndjen veten, çfarë bëhet me të, dhe jo vetëm pikët e tij. E vërteta është që njerëzit nuk u intereson se sa di derisa nuk merresh me ta. Për bashkëpunonjës të tënd bën më shumë kur e dëgjon me vëmendje se kur e dëshiron Ai, dhe jo Ti në vend të tij këtë biznes. Ky biznes ndërtohet nga njerëz këmbëngulës dhe aktiv, dhe stabilizohet nga konsumatorët e produkteve. Me siguri ke dëgjuar shumë historira në FLP që “Herë pas here fshija pluhurin nga Touch-i im,

dhe njëherë vendosa dhe u bëra manager”, apo “Hëngra, piva, lyeva, fryva, vendosa – shkëmbeva përvojat e mia dhe u bëra manager”. Diçka e tillë mund të ndodh me këdo. Edhe me ty!

Jam krenare që në skuadrën time marrin pjesë njerëz me vlerë. Po përmend vetëm disa prej të mëdhenjve, të cilët i vlerësoj shumë, të cilët janë shembujt e FLP-s: Robi Varga, Zsolt Leveleki, Zsolt Fekete, Istvan Halmi, Pisti Utasi, Zoli Kovacs, Janos Tamas, Pisti Adam, Tamas Budai, Csaba Juhasz, Kriszta Kiraly, Csabi Toth, ...

Me këtë rast të uroj:

- Këmbëngulje!
- Pranoje dhe jepe dashurinë!
- Bëhu me vlerë dhe vlerëso të tjerët!
- Krijoi siguri për vete dhe familjen tënde!
- Dhe të jesh i lirë si një zog!

Dhe nëse ke nevojë, kujto këtë histori:

*“Dy bretkosa ranë një një kovë me kajmak
– kështu tregonte një plak.
Faqja e pjerrët e kovës rrëshqiste,
kajmaku ishte i thellë dhe i ftohtë.
– Më kot! – thotë njëra.
– S’ka ndihmë, ky është fundi.
Të priftë zoti miku im! –
dhe e thithi shpejt thellësia.
Tjetrën e kishin gatuar
me brum më të fortë,
I dha duarve në kovë.
Fshiu lëngun nga fytyra,
dhe nga sytë që të shihte më mirë.
– Të paktën po notoj ca kohë –
Tha, ose kështu e dëgjova.
Dhe kështu kaluan nja dy orë,
Nuk mendonte se a do mbijetonte dot,
Por notoi dhe notoi,
dhe nuk u dorëzua –
Dhe më në fund doli jashtë kajmakut.*

/Autor i panjohur!

Suksese të shumta!



“S'mjafton vetëm ta pëlqesh të mirën: të mirën duhet ta dëshirosh!”



**ILONA
KÖNCZÖL**
managere



Produktet e FLP-s fillova t'i përdor në vitin 2000, dhe sponsorit im Csaba Toth-it nuk i duhej shumë të më mbushte mendjen, pasi unë e dija që këto ishin të mira, prandaj bleva menjëherë një kuti.

Atëherë punoja akoma në një firmë si managere tregëtie me një pagesë shumë të mirë, dhe mund të udhëtoja çdo dy muaj në çdo breg deti dhe oqeani.

Duhet ditur që në familjen tonë në anën e nënës kanë qenë të shpeshta sëmundjet kanceroze, prandaj isha i përgatitur rreth këtyre sëmundjeve, dhe e dija edhe atë që në krijimin e tyre luajnë rol të madh kimikatet e shumta që hamë.

Dëshiroja t'ua përcillja të gjithëve njohuritë e mia si rreth efektit të shkëlqyer të produkteve, edhe rreth mundësisë së madhe të biznesit që fshihet në këtë.

Natyrisht reagimin e njerëzve shpeshherë nuk e kuptoj: megjithëse dëshirojnë të jetojnë të shëndetshëm dhe të kenë më shumë të ardhura, është një kërkesë tepër e madhe për ta të punojnë për këtë, apo të bëjnë ndonjë skarificë, të heqin dorë nga shikimi i televizorit në mbrëmje apo e pira me shokët. S'kisha shumë qejf që çdo mbrëmje të bindja njerëzit që të veprojnë nëse duan të jetojnë më mirë, kur ata nuk kanë dëshirë, prandaj qëndrova më mirë tek përdorimi i produkteve.

Për dy vjet i konsumova rregullisht produktet dhe dallova që ndërkohë që çdo dimër më kapte ndonjë lloj gripit, gjatë kësaj periudhe për herë të parë në jetën time nuk më ndodhi asgjë.

Dhe u gënjeva, pasi mendova se tani jam aq i shëndetshëm sa që nuk duhet t'i konsumoj më këto produkte.

Por siç kam mësuar nga miku im më i mirë, Andreas Berghofer: “Ose e bën vetë, ose jeta të detyron ta bësh” – dhe mua më detyroi të përgjunjësja.

Tani duke e menduar të gjithë arrij në përfundimin që: përse jemi kaq të papërgjegjshëm në njerëzit – natyrisht me mua në krye – përse presim që të ndodh ndonjë problem serioz?

Në këtë moment iu drejtova përsëri duke qarë – pas pesë vitesh – sponsorit tim, **Csaba Toth-it**, me ndihmën e të cilit u rregullua gjithçka, por atë që kalova nuk ia uroj as armikut tim më të madh.

Pashë veten në pasqyrë dhe vura re që isha plakur me njëzet vjet, dhe nga femra gazmore, me temperament dhe e buzëqeshur u bëra një njeri i këputur.

Falenderoj **Csaba-n** që nuk më la në këtë gjendje dhe ma ofroi përsëri mundësinë e biznesit të cilin në mes të janarit të 2006-ës e fillova në mënyrë aktive. Ishte çështje e rëndësishme për mua se si do ta ndërthur këtë me punën time, pasi jo shumë kohë më parë fillova një biznes privat dhe dihet që vitet e para nuk janë të lehta, nevojitet punë, dhe jo pak.

Por e dija edhe atë që njeriu ka kohë për atë që dëshiron. Koha e kaluar në firmën time më zgjoi në faktin që megjithëse bëja mirë para, nuk kisha kohë t'i shpenzoja; shpeshherë ndodhte që isha brenda në orën pesë e gjysëm në mëngjes dhe nisesha për në shtëpi pas orës 11 në darkë, më kot kisha makinë të bukur, udhëtoja vetëm nga shtëpia në punë. Dhe kjo ishte gjithçka, vetëm që jo ajo për të cilën ëndërroja! Përpiqesha t'i organizoja mirë punët e mia; në këtë më ndihmoi edhe shfrytëzimi i kohës që kisha mësuar dikur, që të mos bëja rrugë bosh, që t'i radhisja gjërat sipas rëndësisë, dhe desha të kisha sukses!

Gjatë një muaji e gjysëm arrita nivelin 8%-ësh, kurse tre muaj më pas nivelin 13%-ësh. Por në korrik më ndodhi diçka që i ndodh afërsisht një në një milion njerëzve: një nga bashkëpunonjëset e mia 8%-she mbeti shtatzanë, një tjetër dy ditë më pas e operuan nga zemra, kurse i treti pikërisht në atë periudhë u shpërngul në shtëpi private, dhe aty ka mjaft punë për të bërë. Do të gënjeja po të thoja që nuk më ndikoi kjo gjë. Si jo! Dhe jo pak, e cila dallohej edhe në rrezatimin tim, pasi morra refuzime si asnjëherë tjetër, dhe si rezultat i kësaj në fund të vitet më tepër mjekojta plagët e mia.

Por për fat të mirë një nga skuadrat e mia 8%-she u nis përsëri me në krye **Aniko Ujvari-n dhe Janos Zsamboki-n**, të cilët ishin të parët që u bashkuan me mua dhe të cilët i falenderoj për besimin që patën tek unë, kështu që në janar edhe unë e mblodha veten dhe u nisa bashkë me ta. M'u kthye përsëri dëshira për jetën të cilën e shtoi edhe rally i Stockholmit, dhe më në fund u takova edhe me njerëz me të cilët një vit më parë nuk kisha guxim. Atëherë isha drejtuesja e sekretarisë së drejtorit të përgjithshëm të Departamentit Kombëtar të Traumatologjisë, prandaj një nga të parët që iu drejtova ishte pikërisht ai, shefi im i drejtpërdrejtë, Dr. Antal Renner, i cili është një kirurg dore me famë botërore. Mësova

shumë nga ai në aspektin njerëzor, dhe ndër të tjerat nga ai dëgjova që "njeriu i zgjuar e parandalon problemin, kurse më pak i zgjuari shpëton atë që mund të shpëtohet."

Duke njohur gjendjen aktuale të shëndetësisë, si dhe prespektivat, ndoshta s'kam pse ta them që ishte i hapur për gjithçka. Duke u nisur nga kjo iu drejtova edhe një kolegu tjetër mjek, kështu që tani mund të them që në skuadrën time marrin pjesë tre profesor kirurg dhe disa kryemjek.

I falenderoj shumë ata që patën besim tek unë dhe ishte një ndjenjë tepër e mirë që edhe pas shumë vitesh kishin respekt për mua.

Filluan të më shtoheshin përsëri pikët, por nga ana tjetër më inatosnin prapë njerëz rreth të cilëve e dija që u nevojiteshin paratë, dhe prapë nxirrnin pretekste, si psh. iu dhemb koka etj.

Në fillim të majit ndjeva që: unë u përpoqa aq shumë t'u mbush mendjen njerëzve duke pritur që dikur të nisen, sa që m'u mbush kupa dhe vendosa të mos pres asnjëri; po të jetë kështu, e bëj edhe vetë.

M'u kujtua përsëri ajo që kisha mësuar më parë: "Ti shko përpara dhe njerëzit e duhur do të ndjekin vetë!"

Dhe kështu ndodhi, pasi skuadra filloi të punonte, mes tyre **Laci György, Ildi Olah, Edina Fekete, Ildi Farkas, Hajni Wolf dhe natyrisht Jani Zsamboki**, të cilët shpresoj që së shpejti t'i shohim në skenë, pasi krijojnë një skuadër fantastike.

Morra shumë mbështetje dhe këshilla nga linja ime e sipërme, **Istvan dhe Rita Halmi**, për të cilën i falenderoj shumë; faleminderit që më kushtuat kohë dhe patët besim tek unë – njerëz të mrekullueshëm.

Por një javë përpara mbylljes së muajit nga 72 pikët që më mungonin kisha vetëm 35, dhe po ta mendojmë

mirë është e pamundur të bësh 37 pikë brenda një jave, sidomos kur kemi përpara Success Day, festat katolike, dhe të premtën shumë njerëz udhëtojnë, prandaj në të vërtetë kisha vetëm katër ditë për këtë.

Por mua nuk më bënin përshtypje festat, pasi mendova që edhe gjatë festave mund të bisedohet, edhe në këtë kohë ka të sëmurë, dhe ndoshta nuk është problem që edhe në këto ditë ndihmojmë njerëzit.

Kështu që punova edhe gjatë festave. Por më 31 maj më mungonin akoma më shumë se 14 pikë, dhe nuk e kisha aspak idenë se si, por e dija, e ndjeja që do ta arrij, sepse e dëshiroja.

Më në fund falë zotit e arrita, pasi në javën e fundit u mbodhën më shumë se 40 pikë, të cilat zakonisht mblidhen gjatë një muaji, dhe kjo gjë më bëri të mendohem: nëse njëherë e arritëm, përse të mos e bëjmë edhe herë tjetër?

Në arritjen e kësaj luajti një rol tepër të madh linja ime e sipërme, **Teca Hermann**, tek e cila njoha një drejtuese fantastike dhe një NJERI të mrekullueshëm, rreth të cilës mund të mendoni se ka një biznes aq të madh sa që mes mijëra njerëzve nuk ka kohë të informohet për të gjithë, por ajo çdo ditë merrte mundimin të më motivonte dhe mbështeste; një njeri e cila nuk e ka harrur se si e filloi. Është një shembull i denjë për të gjithë, për mua padyshim, faleminderit!

Më kujtohet një thënie e Tersanszky-t e cila më ka shoqëruar gjatë gjithë jetës: "E sheh, duhet vetëm të kesh dëshirë! Atë që e dëshiron njeriu herët a vonë e arrin."

Jam krenare që mund të punoj në skuadrën e FLP-s e cila ka drejtues të cilëve mendoj se mund t'u bindim edhe drejtimin e shtetit, sepse mund të jemi të sigurt që ndodhemi në duart më të mira.

“Baza e mirëqenies është pakënaqësia”



**ISTVAN
KILIAN**
manager



Një pasqyrë e shkurtër: e gjithë ngjarja fillon afërsisht dy vjet më parë; shoku im Attila Pataky më prezantoi tek një miku i tij, Dr. Sandor Milesz, rreth të cilit atëherë nuk dija shumë. Pas kësaj isha mysafir i rregullt si në takimet e firmës, edhe në mbledhjet familjare.

Pothuajse gjashtë vite më parë, në në mbrëmje në Hortobagy, më thirri **Tamas Biro**. Në fillim më tha: Ti, Pisti, je nga Miskolci apo jo? (Dhe këtu të gjithë e marrin me mend se si do të ishte vazhdimi!) Ia ndërpreva në kohë fjalën. Po ta dija në atë kohë atë që di tani, atëherë do ta dëgjoja deri në fund! Bëhet fjalë për një njeri të respektueshëm, i cili meqë isha miku i shefit të madh, më kërkoi falje dhe folëm për gjëra të tjera. Me kalimin e viteve kalova shumë kohë në shoqërinë e rrjetndërtuesve.

Isha vështrues i qetë i një bote plotësisht të re për mua. U njoha me njerëz tepër me vlerë në këtë profesion (por atëherë këtë nuk e kuptoja), si përshembull **Kata Ungar, Jozsi Szabo, Miki Berkics, Tomi Biro** – pa i përmendur të gjithë; kërkoi të falur nga ata që nuk i radhita. Jetojmë vitin 2007, dhe më duket se erdhi koha.

Me një mikun tim nga Tiszaujvarosi, **Peti Kis**-in, me të cilin kaluam shumë kohë në Shtetet e Bashkuara, vendosëm të marrim pjesë në këtë kompani. Sipas zakonit dhe mënyrës morra në telefon Sandor-in, i kërkova një takim dhe më dha. I shkuam në zyrë, në ndërtesën qendrore. Pas një bisede prej disa minutash shprehu gëzimin e tij duke thënë: “Më në fund të erdhën mendtë Kilos!”

Pastaj Sanyi-t i bëmë një pyetje të vogël, por të rëndësishme, duke i thënë se ne dëshirojmë të punojmë me **Tomi Biro**-n. Regjistrimin e bëmë më 13 shkurt. Pas disa ditësh udhëtova në Shtetet e Bashkuara

për dy javë. Kjo është e rëndësishme sepse gjatë kësaj dite nuk munda të punoja. Pastaj në mars u ktheva në shtëpi, dhe bashkë me **Biro Tomi**-n dhe të dashurën e tij **Dia**-n filluam të punojmë në Miskolc.

U përpoqa të përfitoj nga fakti që njoh shumë njerëz. I telefonova edhe njeriu të tillë tek i cili isha i bindur që do më refuzojë, por për çudi: sot ndodhet mes më të mirëve. Kishte edhe njeri tek i cili ushqeva shpresa të mëdha. Për fat të keq duhet të them që puna e tij është e dobët. Kishte edhe njeri të cilin e ftova në një leksion në Kafë Hekurudha në Miskolc, por ai më tha: “Pisti, unë të bëj beton dhe të gërmoj gjithë ditën, por mos më lodh me këtë!” – dhe u largua. Dy javë më vonë më morri në telefon dhe më tha: U mendova! Dëshiroj të marr pjesë mes jush, dua të blej dy kuti për vete dhe të regjistroj dy të njohur.

Pastaj skuadra e Szerencs-it me **Sandor Balogh**-un në krye. Nga Miskolci u nisëm për në Szerencs, dhe që tek kryqëzimi i Zsolcai-t e kuptoi se përse bëhet fjalë. E çova tek Tamas-i, e bleu menjëherë kutinë dhe vendosëm prezantimet. Në fund të muajit të mëpashtëm u bë manager bashkë me skuadrën e tij.

Erdhi 26 maji, dita e madhe: përvjetori i dhjetë dhe Success Day. Këtu u kualifikova si supervisor. Nga pikëpamja ime në këtë ditë isha manager me 182 pikë, me një manager dhe tre supervisor në linjën e poshtme!!! Dëshiroj ta bëj të qartë që as më shkonte ndër mend të ngjitesha në skenë përpara 13 000

njerëzve në Arenën Sportive Laszlo Papp, prandaj as nuk u veshë siç duhet, por kur dëgjova emrin tim mendova se duhet të ngjitem, pasi më thirri vetë drejtori i Europës, **Peter Lenkey**.

Në skenë kërkova ndjesë nga të gjithë: pantallonat e shkurtra nuk tregonin mungesën e respektit, por thjesht nuk doja të shfaqesha! Tani prapa më vjen keq, pasi ishte një nder shumë i madh që më uroi personalisht njeriu i parë i kompanisë, **Rex Maughan**, dhe natyrisht edhe drejtori gjeneral, **Dr. Sandor Milesz**.

Duhet të prisja edhe pothuajse një muaj për ta marrë zyrtarisht medaljen e managerit. Këtë e ndoqi

një kurs përgatitor fundjave në Hotel Ramada në Balatonalmadi, e cila për mua ishte gjithashtu Success Day.

Karoly Rekasi pas supervisorëve dhe assistant managerëve thirri në skenë managerët. Pres që të ngjiten disa dhe pastaj në fund edhe unë të bashkohem me ta. Karoly i thërret për herë të tretë managerët, por asnjëri nuk lëviz! U përballova me ndjenjën e pazakontë që duhet të dal vetëm përpara aq njerëzve dhe të them diçka. Ishte një fjalim i dobët, por publiku dhe bashkëpunonjësit e mi ishin fantastik, e vlerësuan rendimentin tim duke më duartrokitur në këmbë.

Karoly Rekasi me një mjeshtri të vërtetë u përpoqi të ul tensionin që

përjetova në skenë (prandaj nuk ishte një ndjenjë e zakonshme). Pastaj pasoi Success Day i qershorit kur morra medaljen e managerit, dhe përveç kësaj në këtë ditë në qafë m'u vendos një shirit ku shkruhej: Conquistador Club.

Unë nuk e ndjej akoma rëndësinë e këtij shiriti, pas jam akoma fillestar në këtë profesion, por sipas Tomi Biro-s kjo është diçka e madhe, pasi ndërmjet gjithë punonjësve, duke përfshirë edhe shtatë shtete përveç Hungarisë (gjithsej më shumë se gjysëm milion njerëz), isha i teti më i suksesshmi në muajin maj.

Falenderoj **Tomi Biro-n** dhe të dashurën e tij, Dia, sepse pa ta nuk do ta kisha arritur dot as këtë.



Shtypi

Botuese: Kompania Forever Living Products, Hungari.

Redaktoi: FLP Magyarországi Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Redaktori kryesor: Dr. Milesz Sándor

Redaktor: Kismárton Valéria, Veress Angéla, Rókás Sándor

Përgatitja për shtypje: Tipofill 2002 kft.

Grafika: Teszár Richárd, Buzácssy Gábor

Shtypi: Veszprémi Nyomda Zrt. U përgatit në 49 250 kopje

Për përmbytjen e artikujve shkruarit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!

Përkthyes, redaktues: shqip: Dr. Marsel Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anić Antić Žarko

– serb: Tóth-Kása Ottília, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Biro 2000 Ljubljana



Sonya[®]
Color Collection
Konkurs Bukurie

Të dashur Punonjës!

Me këtë rast dëshiroj të shpall Konkursin e Bukurisë Sonya në të cilin mund të paraqiteni nga data 1 korrik deri më 31 gusht 2007. Paraqitja bëhet me një fotografi të gjithë trupit dhe një letër A4 vetëprezantuese. Në konkurs mund të paraqitet çdo femër që ka mbushur 18 vjeç, është distributore e FLP-s, dhe ka bërë të paktën një blerje në vendin e saj. Konkursi eliminator do të bëhet më 13 shtator në sallën e leksioneve të rrugës Nefelejcs në Budapest, këtu çdo pjesëmarrës mund të shfaqet me veshjet e veta të preferuara. Finalja e Hungarisë do të mbahet më 17 nëntor në Arenën Sportive Laszlo Papp të Budapestit, këtu pjesëmarrësit do të shfaqen me rroba banje dhe fustane kokteili. Shkalla e tretë, apo finalja e Europës do të jetë në shkurt në Rally-n European, këtu pjesëmarrësit do të shfaqen me rroba banje dhe fustane elegante balloje – Hungaria do të përfaqësohet nga Miss Sonya Hungary e zgjedhur. Për ato që marrin pjesë në finale do të mbajmë një kurs përgatitor dy ditor në 15-16 nëntor në Szirak.

Sonyia®

Color Collection

Sy të shëndetshëm dhe të mrekullueshëm



Shikimi është një thesar i çmuar, pasi e përdorim nga dita në ditë. Organizmin tonë e shërbejmë me lëndë ushqyese të domosdoshme, por ndërkohë jemi të prirur të harrojmë se e rëndësishme është të bëjmë gjithçka edhe për shëndetin e syve.

Gjendja shëndetësore e syve shpeshherë pasqyrohet nga rrathët e errëta apo qepallat e enjtura. Në shikimin tonë duken shumë efekte të ndryshme: faktorët dëmtues të mjedisit, mungesa e lëngjeve, monitori, ushqimi, ajri i thatë, lentet, alergjia, tiparet e trashëguara, apo kalimi i kohës.

Me koleksionin special të produkteve me bazë aloe vera të Forever Living Products mund të ruajmë rininë, freskinë dhe shëndetin e syve tanë. Të kemi një shikim rrezatues me ndihmën e Forever-it!

Forever Vision është një produkt i shkëlqyer me boronicë, lutein, zeaxanthin, si dhe antioksidantë dhe lëndë të tjera ushqyese. Boronica, si një bimë mjekësore e njohur, përgjigjet për shikimin e mirë, si dhe qarkullimin e gjakut të syrit.





e errëta. Forever Alluring Eyes falë përmbajtjes së lartë të aloe barbadensis, komponentëve hidratues me bazë kokusi dhe jojoba, si dhe vitaminës E e sjell në gjendje të mirë lëkurën dhe siguron përmbajtjen e saj të lëngjeve.

Për arritjen e efektit më të mirë përdoreni në mëngjes dhe në darkë duke e lyer lehtë me mollëzën e gishtit mbi lëkurën e ndjeshme rreth syrit. Shpërndajeni kremi me goditje të buta deri sa të përthithet.

Në fund të ditës përdorni larësin e bojës së syrit **Sonya Eye Makeup Remover!** Kjo formulë tepër e kujdesshme aloe vere e largon mirë bojën e syrit ndërkohë që e kondicionon dhe hidraton qepallën.

Falë përmbajtjes së veçantë të xhelit aloe barbadensis të stabilizuar e mjekon dhe e mban të butë lëkurën e ndjeshme rreth syrit.

Sonya Colour Concealer Wheel është një rreth korrigjues i veçantë, me ndihmën e të cilit mund të korrigjoni tonin dhe mungesën e njëtrajtshmërisë së lëkurës. Me pesë

ngjyra natyrore zhduk çdo gabim të vogël të lëkurës:

- me ngjyrën manushaqe e bën më të hapur shikimin, një bazë e shkëlqyer nën bojën e syrit
- me jeshilen mund të zhduken njollat e kuqe
- me të verdhën mund të korrigjoni rrahët e errëta nën sy
- me ngjyrën bezh të çelët mund të ndiçohet toni, si dhe mund të vihet mbi gabimet e vogla
- bezha mund përdoret mbi çdo njollë tjetër

Theksojini sytë me **bojën e syrit Sonya** – zgjidhni ndërmjet 24 llojeve e ngjyrave, ose përdorni një nga triotona të përzgjedhura! Me **lapsin e syrit Sonya** dhe **spiralin e syrit Sonya** mund të merrni një rezultat të përsosur.

Mos harroni që sytë dëshirojnë trajtim dhe kujdes të përditshëm pranë shplodhjes së duhur.

Përdorni plotësuesit ushqimor dhe produktet tona me cilësi të shkëlqyer duke i kushtuar në këtë mënyrë vëmendjen e duhur ruajtjes së shikimit tuaj rrezatues.

Luteina, karotenoid që gjendet në shumë fruta dhe perime, shërben mbrojtjen e retinës. Zeaxantina, astaxantina, si dhe karotenoidet tjerë luajnë rol të rëndësishëm në mbrojtjen e njollës së verdhë.

Me përdorimin e rregullt të **Forever Alluring Eyes** mund të keni një shikim të shplodhur dhe të freskët. Kremi ynë kundër rrudhave trajton dhe hidraton lëkurën tepër të ndjeshme rreth syrit, ul shfaqjen e rrudhave, ul në mënyrë të dukshme enjtjen dhe zbeh rrahët



Qendër kozmetike në kështjellë

Kështjella e Szirak-it u ndërtua në mes të shekullit XVIII. Kështjella Teleki e fshehur mes pemëve disashekullore është një nga perlat e vendit tonë, e cila tani afër u zgjerua me një qendër wellness, duke u bërë kështu një vend i preferuar pushimi për udhëtarët, tregëtarët, turistët, sportistët apo gjuetarët e zonës që dëshirojnë shëndet dhe bukuri.

Në kështjellën Teleki funksionon një hotel me apartamente, kurse qendra kozmetike u krijua në ndërtesën me tre kate të hanit të vjetër. Për krijimin e saj u përdorën më shumë se 2000 metrakatrorë bambu. Planifikuesit e realizuan plotësisht idenë e tyre: në pjesën e brendshme të ndërtesës dominojnë kryesisht tiparet e oqeanit paqësor, këtij stili i përputhen edhe shërbimet e ndryshme.

Në katin më të lartë të qendrës kozmetike ndodhen apartamentet e mobiluara me orendi indoneze dhe kedri kinez; komforti, shpłodhja dhe relaksimi i plotë i vizitorëve sigurohet nga orendi që nuk gjenden askund në Hungari. Kur mysafiri kapërcen pragun e apartamentit i duket sikur mbërrin diku larg, në një pikë të këndshme të Azisë. Por komforti nuk varet vetëm nga orenditë. Mysafiri e ndjen veten si në shtëpinë e vet nëse e ndjen se çdo shërbim i hotelit shërben atë. Prandaj një nga apartamentet është krijuar në mënyrë të tillë që të mund të shpłodhen edhe fëmijët: për ta kanë mobiluar një ambient të veçantë banimi. Kati i mesëm është ishulli i shpłodhes së plotë dhe zbukurimit. Këtu bambuja ndërthurret me gurin. Femrat mund të regjen në vaska me aloe vera, mysafirët e ardhur nga qyteti mund t'i pastrojnë mushkритë në kabinat e kripës, tregëtarët e lodhur nga stresi mund të shijojnë mrekullinë e masazheve tailandeze, indiane dhe të tjera ekzotike, pastaj mund të shpłodhen në sheshin special të përgatitur për këtë. Në qendrën kozmetike Sonya që gjendet në këtë kat ofrohen afërsisht pesëdhjetë lloje trajtimesh kozmetike, berberët krijojnë modele të mrekullueshme

flokësh, kurse specialistët kozmetik përgatisin makijazhin ditor, të mbrëmjes apo të ballos.

Kati më i poshtëm është zona e atyre që duan me të vërtetë të shpłodhen, zona e pishinave. Këtu ai që dëshiron të ushtroj sport mund të notoj në dy pishina me rrumë të programueshme, kurse ai që dëshiron një banjë me ujë të ngrohtë dhe masazh të këndshëm, apo dëshiron vetëm të bisedojë, mund të relaksohet në një pishinë spa. Interesantja e whirlpool-it është që rrymat janë ndërtuar sipas sistemit Shiatsu në pika e caktuara të pishinës. Pjesën e wellness-it e bëjnë edhe më komfote kabina e avullit dhe sauna.

Bari tropikal është një ekperiencë e veçantë të cilin planifikuesit e kanë ndërtuar duke krijuar një atmosferë oqeanike. Meqë bëhet fjalë për një qendër shëndeti, natyrisht mund të provohen edhe kokteile të përgatitura nga bimë mjekësore.

Kështjellën e Szirak-it të rrethit Nograd përveç parkut të vjetër, ajrit të shkëlqyer, mundësive të kalorësimit, shëtitjes me karrocë, shëtitjes në natyrë dhe të gjuetisë, Qendra e Shëndetit dhe Kozmetike Sonya e bën edhe më tërheqëse për mysafirët vendas dhe të huaj. E përmendim thjesht si diçka interesante: në dorëzimin e qendrës në Hungari erdhi edhe presidenti-drejtori i përgjithshëm i Forever Living Products International dhe Forever Resorts, Rex Maughan. Ndërmjet objekteve të shumta të ngjashme e tyre është edhe Southfork Ranch i njohur mirë nga seriali Dallas.





HOTEL KASTÉLY
SZIRÁK



Senya®
Color Co

